



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr. 76 datë 30.06.2020

PËR

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR NDRYSHIM
TË TARIFAVE TË SHOQËRISË UJËSJELLËS KANALIZIME FIER

Në mbështetje të nenit 13, 14, 21 dhe 22 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**ligji nr. 8102**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 09.12.2015 "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" (**Vendimi nr. 40**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 09.12.2015 "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" (**Vendimi nr. 41**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 09.12.2015 "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura" (**Vendimi nr. 42**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 30.06.2020 pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësjiellës Kanalizime Fier sh. a për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

Konstatoi se:

Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Fier është licencuar me vendimin e KKRR nr. 67, datë 19.12.2019 "Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Fier sh.a" pas përfundimit të riorganizimit sipas ndarjes së re territoriale, bazuar në pikën 3, të kreut II të VKM nr. 63, datë 27.01.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura".

Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Fier i është drejtuar Entit Rregullator të Ujit me shkresën nr. 136 prot. datë 18.02.2020 me lëndë "Aplikim për unifikim tarifash", ku kërkohet nivel i ri tarifar për zonat e reja që i janë shtuar zonës së shërbimit, me qëllim unifikimin e tyre me tarifat që shoqëria aplikon për zonën ekzistuese.

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria UK është plotësuar sipas Metodologjisë së Vendosjes së tarifave.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i shoqërisë UK Fier është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në Vendimin nr. 40 dhe kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Fier për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime.
2. Drejtoria Teknike Ekonomike detyrohet të njoftojë shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Fier sh.a dhe Bashkinë Fier për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Ndriçim Shani